



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 14364 Prot

Shkodër, më 09 10.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim Relacioni dhe Projekt - Vendimi.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim Relacionin dhe Projekt - Vendimin:

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT
TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR
VITIN 2023”**

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Bardet Beci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2023

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2023

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË
DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2023”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.____.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 24, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“, i ndryshuar; të nenit 38 të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social“, i ndryshuar, pika 4/a e VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në suvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër Nr. ____ Prot, datë _____.____.2023.

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të qirasë mesatare mujore në treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në zonat urbane dhe ato rurale në territorin e Bashkisë Shkodër, si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi mesatar në zonat urbane (lekë pa tvsh) | Çmimi mesatar në zonat rurale (lekë pa tvsh) |
|-----|--|--------|-------|--|--|
| 1 | Banesa me qira (Apartament tip garsonierë) | muaj | 1 | 16,000 | 12,500 |
| 2 | Banesa me qira (Apartament 1 + 1) | muaj | 1 | 22,700 | 17,500 |
| 3 | Banesa me qira (Apartament 2 + 1) | muaj | 1 | 31,500 | 21,000 |
| 4 | Banesa me qira (Apartament 3 + 1) | muaj | 1 | 38,500 | 25,000 |

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë projekt-vendim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.


KRYETAR

Benet Beci


Zv/Kryetar



Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik



Drejtorja Juridike







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË
DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2023”**

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 8, nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; pika 1 e nenit 38, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social“, i ndryshuar, pika 4/a e VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij.

Në kuadër të detyrimeve dhe me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim, përmes subvencionimit të qirasë si instrument financiar i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë, duhet të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak vlera maksimale e subvencionit të qirasë sipas nenit 38, pika 1 e ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social“, i ndryshuar.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, pika 4/a, shprehet që për përcaktimin e vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, duhet ndër të tjera të përcaktohet vlera mesatare e qirasë në tregun e lirë.

Sa më sipër, për realizimin e testimit të tregut janë kontaktuar 8 operatorë, të regjistruar pranë organeve tatimore si subjekte që ofrojnë shërbime imobiliare. nga të cilët vetëm 5 subjekte kanë dhënë informacion e kërkuar dhe në bazë të këtij informacioni kemi llogaritur vlerat mesatare të qirave për të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, sipas strukturave të apartamenteve, si më poshtë:

Zona urbane

| 25,Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi mesatar (lekë pa tvsh) |
|--|--------|-------|-----------------------------|--|---------------------------------|-------------------------------|---|------------------------------|
| | | | SHKODRA CRAIGLIST L76823001 | Agjencia e Shërbimeve Des Real Estate L81605015T | Marco Polo Property L56309007 A | CENTURY 21 Vision K81901012 G | Agjencia Extra The real estate Company J64103051P | |
| Banesa me qira (Apartament tip garsonierë) | muaj | 1 | - | 15,000 | 17,500 | 15,000 | 17,500 | 16,000 |
| Banesa me qira (Apartament 1 + 1) | muaj | 1 | 26,000 | 21,500 | 22,500 | 22,500 | 21,000 | 22,700 |
| Banesa me qira (Apartament 2 + 1) | muaj | 1 | 33,500 | 30,000 | 30,000 | 37,500 | 26,500 | 31,500 |
| Banesa me qira (Apartament 3 + 1) | muaj | 1 | 40,000 | 37,500 | 37,500 | 42,500 | 35,000 | 38,500 |

Zona rurale

| 25,Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi (lekë pa tvsh) | Çmimi mesatar (lekë pa tvsh) |
|--|--------|-------|-------------------------------|--|--------------------------------|-------------------------------|---|------------------------------|
| | | | SHKODRA CRAIGLIST (L76823001) | Agjencia e Shërbimeve Des Real Estate L81605015T | Marco Polo Property L56309007A | CENTURY 21 Vision K81901012 G | Agjencia Extra The real estate Company J64103051P | |
| Banesa me qira (Apartament tip garsonierë) | muaj | 1 | - | - | 12,500 | 10,000 | 15,000 | 12,500 |
| Banesa me qira (Apartament 1 + 1) | muaj | 1 | - | - | 15,500 | 17,500 | 19,500 | 17,500 |
| Banesa me qira (Apartament 2 + 1) | muaj | 1 | - | - | 17,500 | 22,500 | 23,000 | 21,000 |
| Banesa me qira (Apartament 3 + 1) | muaj | 1 | - | - | 22,500 | 27,500 | 25,000 | 25,000 |

Në këto kushte, me qëllim përmbushjen e detyrimeve dhe ndjekjen e procedurave të nevojshme për zbatimin e instrumentit financiar të Subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, paraqesim për miratim projekt-vendimin:

“Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023”.

Duke e vlerësuar prioritar kërkojmë miratimin nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit, Shëndetit Publik

Arline Krapo



KRYETAR
Benet Beci